



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:283254

Datë: 01.12.2024

Numri i dokumentit: 06530194

C.nr.594/23

Gjykata Themelore Gjakovë - Degë Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Petrit Curri, si dhe me Zyrтарin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit D.K.me numër personal ... mësimdhënës në SHFMU “Tafil Kelmendi” në fshatin B., Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. Labinot Murati nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim në emër të licencimit/kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 01.12.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Drenushë Kryeziu.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që paditësit **D.K.** t’ia paguaj në emër të kompensimit të borxhit në emër të licencimit/kualifikimit, për periudhën kohore nga data 01.08.2021 deri më datë 31.03.2023, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës paga bazë 421.00 € * 27% i pagës bazë (113.67 € - 58.32 diferencë e paguar në page = 55.35 €) x 18 muaj gjithsej 18* 55.35 = **996.30** €, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 21.11.2023, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës paditësve dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi D.K.përmes të autorizuarit të saj Av. Labinot Murati nga Prishtina në këtë gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim mbi bazën e kualifikimit/licencimit, sipas padisë paditësi është i punësuar pranë të paditurës në bazë të Kontratës së Punës në pozitën mësimdhënës, është i licencuar dhe kualifikim universitar, paga bazë e paditëses është 421.00 euro , paditësi nga data 01.08.2021 e deri më datë 31.01.2023 ka realizuar 18 muaj pune, i takon kompenzimi shtesë në lartësi prej 27% të pagës bazë në shumën prej 113.67 euro në muaj, ndërsa e paditura i ka paguar paditësit

vetëm shtesën në shumën prej 58.32 euro, kurse nuk i ka paguar diferencën prej 55.35 euro, gjykatës i ka propozuar të aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shtesat në lartësi prej 27 % të pagës bazë prej 421.00 euro diferencën në shtesë në shumën prej 55.35 euro duke filluar nga data 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023 për 18 muaj në shumën prej 996.30 euro, të gjitha me kamatë prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë deri në përmbarimin e aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t'ia paguaj shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 21.00 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi në këtë rast e lidhur me pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive, për faktin që bazë të kontratës së mësimdhënësve kualifikimi i paguhet qdo mësimdhënësi që është paraqitur në kontratën e punës gradimi mbi pagën bazë, Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, në veçanti nenin 7 [Licencimi] ku paditësit pretendon se i takon e drejta e kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, kjo dispozitë përcakton se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi, të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% të pagës bazë, padia është në tërësi e pabazuar dispozitat e këtij neni nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit, por kjo dispozitë se lartcekur shihet qartë që qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar dhe assesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PAGAT, ku në nenin 35 janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu që nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare të të paditurës: kompensimi për orët shtesë, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë të pranuar nga enti i Statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar me nenin 7 të kontratës , për çka pretendimet e paditësve për mungesë dhe mos planifikim të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, në paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se "Pagat e punëtorëve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet nënligjore në fuqi, për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHKut, nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit në Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim.", andaj me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara, poashtu edhe po që se në këtë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës kolektive të arsimit vitit 2021, kemi të bëjmë më parashkrim në baz të nenit 35 dhe neni 35 pika 1 e LMD —së dhe kjo kërkesë padi është e

pasafatshme pasi që është paraqitur pas afatit ligjor me datë 01.11.2023 pasi ka hyrë kontrata kolektive e vitit 2021, në fuqi pasi kjo kontratë është shkëputur më datë 22.11.2022, i ka propozuar gjykatës të refuzoj si të pa bazuar padinë e paditësve.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Kontratën e Punës nr.11/227 të datës 11.09.2017, Diplomën e datës 1710.2016, Licencën e Mësimdhënësit nr.... dhe Listën e Pagës.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa e aprovojë tërësishtë për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompenzimin e plotë në emër të licencimit/kualifikimit, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas nenit 7 paragrafi 1, pika 3 në të cilën përcaktohet se ***“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë”***.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008 në pikën 4 përcaktohet se ***“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%, me diplomë, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 % dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*** ndërsa nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të nxjerrë nga seanca e përgjithshme i datës 09.10.2023 GJ.A-SU 214/2023 i cili derivon nga vendimi i Qeverisë së Kosovës në pikën I përcaktohet se ***“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensimin mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008,”*** kjo gjykatë vlerëson se mbi bazën e Kontratës Kolektive- Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës paditëseve i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, poashtu sa i përket të drejtës në kompensimin e mjetëve në emër të licencimit/kualifikimit, gjykata u bazua në diplomat e kualifikimit të paditësit dhe licencimin.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve ***“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për***

përmbushjen e tyre” ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se “Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.

Meqenëse nga parashtrësja e padisë u konstatua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”,* ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”,* e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e në emër të kualifikimit, andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e paditurës, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e mjeteve në emër të licencimit obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”,* ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”,* sa i përket pretendimeve të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2021, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë e ka parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje

faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashkrimit të padisë (21.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.2 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë dhe atë në emër të parashkrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 , dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.594/23 me datën 01.12.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.